



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 878/14 Prot.

Tiranë, më 23/6 /2017

VENDIM

Nr. 83, datë 23/6 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” përfaqësuar nga aktivisti i saj, Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 878 Prot., datë 01.06.2017, ndaj Autoritetit Publik “Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 12.05.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

1. Shkollat në të cilat zbatohet programi “Shansi i Dytë” në Drejtorinë Rajonale Arsimore Korçë.
2. Numrin e nxënësve që frekuentojnë programin “Shansi i Dytë” në secilën shkollë.
3. Sa prej tyre i përkasin komunitetit egjiptian dhe rom?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 878, datë 01.06.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 878/1 Prot, datë 05.06.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 12.06.2017.

Autoriteti Publik është përgjigjur me shkresën nr. 878/2 Prot., datë 09.06.2017, duke refuzuar vënien në dispozicion të kërkuarit informacionin me arsyetimin se të dhënat e kërkuara cilësohen si të dhëna sensitive. Gjithashtu, Autoriteti Publik pretendon se kërkesa nuk është e formuluar qartë dhe nuk përcakton qëllimin e përpunimit të të dhënave të kërkuara në mënyrë të tillë që t’i lejojë Autoritetit Publik të vlerësojë nëse këto të dhëna duhet të jepen apo jo.

Komisioneri, pas shqyrtimit të ankimit dhe konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”, është një informacion me karakter të qartë statistikor i cili nuk zbulon identitetin apo të dhëna të tjera personale të nxënësve. Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i cili ndër të tjera rregullon përpunimin e të dhënave personale për qëllime statistikore.

Sa më sipër informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2. të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik" dhe si i tillë, dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e organizatës "Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome" ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të organizatës "Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome", Nr. 878 Prot., datë 01.06.2017, kundër Autoritetit Publik "Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë", për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 12.05.2017, brenda datës 30. 6 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 23. 6 .2017.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
